


Bione
Construction



Rreth Nesh

BI ONE Construction Group i ka fillesat e saj 15 vite më parë, ku rrugëtimi i suksesshëm nisi me emrin e saj të parë si “BI Construction” me themelues dy djem të rinj dhe vizionar, z. Ilir Dabulla dhe z. Bledar Çela. Të sprovuar në botën e biznesit prej vitesh dhe në sektor të tjerë të ekonomisë, ata vijuan me vendosmëri dhe largpamësi investimin e kapitalit të tyre në fushën e ndërtimeve civile. Sot, kompania ka marrë trajtën e një grupi, me emër të rinovuar si BI ONE Construction Group, me qendër në Tiranë. BI ONE ka realizuar në total deri më sot 30 projekte ndërtimi ose rreth 250,000 metra katror, si godina banimi, qendër biznesi, rezidenca banimi në zona të ndryshme të Shqipërisë.



BI ONE
Construction

Ndihmojmë klientët tanë të krijojnë një botë më të mirë

Aktualisht kompania BIONE ka në proces një sërë projektesh, godinë banimi “Casa Bosco” në zonën e “Don Bosco”, Tiranë, si dhe rreth 90,000 metra katror ndërtim në zonën e Paskuqanit dhe Kamzës në bashkëpunim me kompaninë tjetër partnere “DAEL Construction” ku kanë zhvilluar projekte rezidenciale banimi në forma godinash si dhe kompleksesh banimi me një cilësi tepër të lartë për të dyja zonat. Cilësi e cila është përkthyer jo vetëm në një shitje të menjëhershme të njësive të banimit por ka ndikuar dhe në rritjen e cmimit mesatar për meter katror në zone si dhe kërkesa e klientëve ka ardhur duke u rritur përsa i përket standardeve të ndërtimit.

Projekti më i rëndësishëm dhe madhor i kompanisë “SeeHëna Residence” në zonën e Mjull-Bathore.

Pikërisht në këtë projekt është aplikuar filozofia bazë e kompanisë BIONE, ku i gjithë projekti është konceptuar sic e shihni bazuar tek kërkesa e klientit. Jetojmë në epokën e marketingut të personalizuar, ku “produktin” nuk e krijon kompania por e dizenjon vet klienti. Ndaj pikërisht tek “SeeHëna Residence” janë ndërthtur 7 tipologji vilash individuale, vila të bashkëngjitura dhe disa lloje apartamentesh duke kombinuar kështu mundësitë më të mira për të patur mbi të gjitha një komunitet më tepër sesa një residence.

Paralelisht me “SeeHëna Residence”, BIONE Construction Group është në proces dhe me disa projekte interesante ndërtimi në bregdetin e jugut të Shqipërisë, në zonën e Drimadhes dhe Dhërmiut. Gjithashtu projektet e reja që priten të realizohen brenda 3 viteve në vazhdim nga kompania jonë, shtrihen në zonën e “Casa Italia”, residence banimi në Farkë, residence banimi në zonën e unazës së re etj.

Projektet që do të zhvillohen në zonën e bregdetit të jugut, janë një sfidë në vetvete edhe për faktin se klientët e interesuar janë shtetas të huaj nga vendet e zhvilluara, cka nënkupton një pritshmëri të lartë jo vetëm për cilësinë e ndërtimit por edhe për filozofinë e konceptit si dhe për vlerën e shtuar që ata kërkojnë kur investojnë në patundshmëri.

30
Projekte

91
Vila

Mbi **1000**
Apartamente

SeeHëna Residence



Sipërfaqje totale
ndërtimi

61,150 m²



Vila

58



Vila të
bashkangjitura

33



Apartmente

88


SeeHëna është më tepër se një vend fizik, është një hapësirë banimi që bën bashkë ëndrrat me shpirtrat tanë dhe na lejon të jetojmë një jetë autentike.

SeeHëna Residence është rezidenca më e re në Shqipëri, e vendosur në kodrën e bukur dhe mahnitëse të zonës Mjull Bathore përbri Saukut.

Ky kompleks rezidencial është shpërndarë mbi një sipërfaqe prej **61,150 m²** dhe synon të krijojë më shumë se vetëm një banesë – synon të ndërtojë shtëpinë e ëndrrave për secilin individ. Këtu gjeni një harmoni të jashtëzakonshme midis dashurisë, rehatisë dhe elegancës. Çdo sipërfaqe dhe çdo detaj është menduar me kujdes, duke përdorur materiale të zgjedhura.

Me një sipërfaqe prej **61,150 m²** ky oazë i qetësisë dhe lumturisë ofron një shumëllojshmëri ambientesh dhe banesash, me **58 vila**, **33 vila** të bashkengjitura dhe **88 apartamente**. Vilat shquhen për stilet e ndryshme, me sipërfaqe që variojnë nga **250 m²** deri në **750 m²**, duke ofruar një kombinim të përsosur të rehatisë dhe elegancës.

Investitori dhe ndërtuesi i projekti **“SeeHëna Residence”** është kompania **“BI ONE Construction Group”** e cila ka një eksperiencë **15 vjeçare** në fushën e ndërtimit. Deri më sot kompania numëron mbi **250,000 metra katror** ndërtime në zona të ndryshme.



Drimades



Sipërfaqje totale

4,000 m²




Vila

12



Sipërfaqje totale
ndërtimi

1,600 m²





Casa Bosco



Sipërfaqje totale
ndërtimi

15,898 m²



Mbi tokë

11,810 m²



Poste Parkimi

114



Apartamente

122

Projekti **"Casa Bosco"** ndodhet në zonën e njohur si lagjja **"Don Bosco"**, saktësisht në rrugën paralele të saj, Rruga "Egnatia" prapa shkollës "Don Bosco".

Sipërfaqja totale e ndërtimit shkon në **15,898 m²**, ku **11,810 m²** janë mbi tokë ndërsa **4,087 m²** janë nën tokë me dy kate -1 dhe -2.

Në total llogariten **122 apartamente** të tipologjive të ndryshme dhe **114 poste parkimi**.

Veçoritë e projektit:

- ▣ Fasadë e venteluar
- ▣ Design modern
- ▣ Planimetri me kubaturë të rregullt
- ▣ Vetrata me izolim termo-akustik që ofrojnë qetësi dhe kursim energjie
- ▣ 2 kate parkim nëntokë
- ▣ 2 ashensora për cdo shkallë
- ▣ Sistem ngrohje-ftohje
- ▣ 500m nga unaza e vogël
- ▣ I pozicionuar në mënyrë strategjike, 20m larg nga unaza e mesme e planifikuar






BI One Construction ka ndërtuar në zonën e **Kamzës** vitet e fundit rreth **100,000 m²**.

Të gjitha janë godina banimi, një pjesë e madhe e tyre janë zhvilluar në formën e rezidencave të mirëfillta duke krijuar kështu komunitete të reja në këtë zonë.

Veçoria e arkitekturës, cilësia e pakrahasueshme e ndërtimit dhe besimi i mijëra qytetarëve që i kanë besuar përmes investimeve të tyre kompanisë **BI One**, janë shembulli më i mirë ilustrues sesi një kompani ndërtimi ka transformuar një zonë të tërë urbane-periferike duke përafruar standardet e ndërtimit të qendrës së Tiranës dhe në Kamëz dhe Paskuqan.





Ky projekt rezidencial sjell një kombinim të arkitekturës bashkëkohore me cilësinë dhe komoditetin maksimal. Me një **fasadë të venteluar** që siguron efikasitet energjetik dhe një **design modern**, ndërtesa ofron një ambient të harmonizuar estetikisht dhe funksionalisht.


Planimetria e mirëorganizuar me **kubaturë të rregullt** garanton shfrytëzim optimal të hapësirës, ndërsa **vetratat me izolim termo-akustik** krijojnë një mjedis të qetë dhe ndihmojnë në kursimin e energjisë.

Komoditeti është prioritet – rezidenca është e pajisur me **dy kate parkimi nëntokë**, **dy ashensorë** për çdo shkallë, dhe një **sistem ngrohje-ftohje** që siguron temperaturën ideale gjatë gjithë vitit.

Një zgjedhje e zgjuar për ata që kërkojnë cilësi, rehati dhe dizajn bashkëkohor **200m** nga rreth-rrotullimi i Sauk-ut.

- ▣ Sipërfaqja e pronës **2073 m²**
- ▣ Sipërfaqja e zënë me ndërtim (kati përdhe i strukturës) **573.02 m²**
- ▣ Sipërfaqja e ndërtimit total mbi toke **3737.07 m²**
- ▣ Sipërfaqja e ndërtimit total nen toke **1305.8 m² (2 kate nentoke)**
- ▣ Sipërfaqja rekreative **150.6 m²**
- ▣ Sipërfaqja e shesheve / trotuarëve dhe hapësira kalimi **688.4 m²**
- ▣ Lartësia e propozuar e ndërtesave **5 kat**
- ▣ Poste Parkimi --**30**

TOTAL: 24 APARTAMENTE 2+1 & 14 APARTAMENTE 1+1



 Rr.Ibrahim Rugova,Green Park-Kulla Nr.2,
9th floor, Ap.53,Tirane

 info@bione.al

 +355 69 70 70 303

